




Pranuar / Dorezuar Prenjeto/Predata Received/Delivery		01.02.2022		2 viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKPMSTHCK	465/2022		1/3	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.1231/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca, anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1231/2021 të datës 30.12.2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë

Ll.S.Nr.10, Prishtinë kundër organit të punësimit, Ministria për Komunitete dhe Kthim në çështjen juridike "Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 01.02.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa A.nr.1231/2021 e datës 30.12.2021, e parashtruar nga ankuesja

**A r s y e t i m**

Ankuesja Udhëheqëse e Divizionit për Komunitetet e Disfavorshme-Ministria për Komunitete dhe Kthim, me datë 30.12.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 6424/2021 të regjistruar me numër A.nr.1231/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokoll 1011 të datës 03.12.2021 të Zv.Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 31.12.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria për Komunitete dhe Kthim, ndërsa Këshilli me datë 18.01.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokoll 6424/2021 të regjistruar me numër A.nr.1231/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 30.12.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 31.12.2021; Kërkesë për caktimin e pozitës së Zv. Drejtorit në DPPA me numër protokoll 966 të datës 12.11.2021; Vendim për formimin e grupit punues për përpilimin e strategjisë së re në



Ministrinë për Komunitete dhe Kthim me numër protokoll 880/3 i datës 01.08.2013; E-mail nga D.T. për H.D. i datës 29.12.2021; E-mail nga V.G. për V.M. i datës 19.04.2021; Kërkesë për aprovim - kërkesa për Fondin e Kuadrove me numër protokoll 2818 i datës 29.12.2014; Kërkesë lidhur me DPPA i datës 01.04.2014; E-mail nga D.T për H.M. i datës 23.12.2021; E-mail nga H.M. për V.M. i datës 24.12.2021; E-mail nga D.T për S.S. i datës 29.12.2021; Vendim me numër protokoll 411 i datës 31.05.2021; E-mail i datës 19.08.2008; E-mail i datës 19.08.2008; Njësia e Auditimit të Brendshëm MKK e datës 21.03.2014; E-mail nga Z.C. për G.R. i datës 26.03.2014; E-mail nga B.A. për D.J. i datës 25.03.2014; E-mail nga N.S. për D.T. i datës 23.04.2014; E-mail nga D.T. për N.S. i datës 22.04.2014; E-mail nga G.R. për S.P. i datës 17.04.2014; E-mail nga G.R. për S.P. i datës 08.04.2014; Plani i veprimit të punës të departamentit për planifikimin e politikave dhe analizat për vitin 2014 me numër protokoll 58 i datës 22.01.2014; E-mail nga K.S. për D.T. i datës 07.07.2015; E-mail nga K.S. për D.T. i datës 30.06.2015; Përgjigje në ankesë e datës 18.01.2022; E-mail nga D.T. për V.M. i datës 07.12.2021; Akt Emërim i datës 20.12.2011; Përshkrimi i Detyrave të Punës i datës 26.11.2012; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i datës 01.10.2018; Përshkrimi i Detyrave të Punës i datës 10.09.2020; Vendim me numër protokoll 1011 i datës 03.12.2021;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesa pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankueses është e palejuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës është konstatuar se ankuesja në bazë Akt Emërimit të datës 20.12.2011, është emëruar në pozitën e punës Udhëheqëse e Divizionit për Komunitetet e Disfavorshme-Departamenti për Planifikim të Politikave dhe Analizave, në kuadër të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.

Ankuesja ka bërë kërkesë me numër protokoll 966 datë 12.11.2021 tek Zv. Sekretari i Përgjithshëm për Komunitete dhe Kthim për caktim në pozitë të Zv. Drejtorit në DPPA, por nga i njëjti nuk ka marrë përgjigje lidhur me kërkesën e saj.

Ndërsa caktimi i SH.T. nga pozita e Udhëheqësit të Divizionit të Prokurimit në pozitën e Udhëheqësit të Divizionit për Integritet Evropian në Departamentin për Planifikim të Politikave dhe Analizave është bërë nga ish Sekretari i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim nga data 01.10.2018. Zv. Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim V.M. në bazë të kompetencave të legjislativës në fuqi dhe me qëllim të organizimit mbarëvajtjes së procesit të aktiviteteve në kuadër të institucionit si dhe duke u bazuar në performancën dhe aftësit menaxheriale ka caktuar SH.T. zëvendësues të Drejtorit të Departamentit për Planifikim të Politikave dhe Analizave në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim nga data 03.12.2021.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, pretendon se Vendimi me numër protokoll 1011/21 i datës 03.12.2021 i Zv. Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim V.M, përveç që është kundërligjshëm poashtu edhe e ka dëmtuar për faktin se i është mohuar caktimi në këtë pozitë të ankueses, dhe se zyrtari i caktuar nuk ka pasur fare të drejtë të caktohet duke kërkuar që Këshilli ta anuloj këtë vendim dhe të aprovohet në tërësi ankesa e saj.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në pretendimet e ankueses dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114





për Zyrtarët Publike, konstaton se çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e punës. Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke ju referuar nenit 124 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim...”,* mbi këtë bazë mungon edhe interesi juridik i ankuesit për të kërkuar ndonjë të drejtë mbi këtë bazë ashtu siç parashihet në Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë respektivisht nenin 24 paragrafin 3 i cili shprehimisht parashihet se: *“Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji”*.

Kolegji mbi bazë të deklarimeve të mësipërme konstaton se me vendimet e kundërshtuara me ankesë, nuk është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik i ankueses lidhur me marrëdhënien e saj të punës, fakt ky që nuk është pretenduar as nga ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshill, kështu që, bazuar në këtë konstatim si dhe në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 nenparagrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë respektivisht nenin 24 paragrafin 3 ,rrjedhë se ankesa A.nr.1231/2021 e datës 30.12.2021, e parashtruar nga ankuesja është e palejuar.

Bazuar në të gjeturat si me lartë, Kolegji pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

#### Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrativ brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi.

Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

### KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS Lënda, A.nr.1231/2021, datë 01/02/2022

Çlirim Zeka

  
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



#### Vendimi i dërgohet;

- ❖ Ankueses
- ❖ Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim; dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHC-së.

